



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.87/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gjlllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirat publike përkatësisht në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), kështu që Koalicioni LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,900.00 (njëmijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 06.06.2017 nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, ka vërejtur se në rrugën Epopeja e Jezercit në Ferizaj, monitoruesi e ynë ka hasur në postierin e kandidatit për deputet nga Koalicioni LDK-AKR, për një tubim elektorale të vendosur në hapësirat publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.03/L-073 duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 1 (një) fotografimin të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të koalicionit LDK-AKR, të datës 06.06.2017 thekson se duke qenë se është evituar shkelja mos shqiptojë gjorbë a e pretenduar, kërkojmë me respekt nga PZAP, që të mos shqiptoj gjorbë subjektit politik ngase efekti i ankesës është arritur me vet faktin se janë larguar postierët nga kandidati. Koalicioni ka bashkangjitur si dëshmi 3 (tri) fotografi që janë pjesë e përgjegjës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se postieri i kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore i koalicionit LDK-AKR, është vendosur në rrugë publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LDP-së e cila përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve

politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga koalicioni LDK-AKR, është shkëlur neni 33,pika b) të LPZ-së pasi që postieri i kandidati për deputet nga Koalicioni janë vendosur ne objektin e hapësirave publike të qytetit të cilën shkeljen e ka pranuar edhe me koalicioni LDK-AKR, në përgjigjën në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posteri i kandidatit për deputet është vendosur në hapësira publik.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se koalicioni në fjalë , ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 87/2017 më datën 07.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Zyhet Haziri

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.